



www.drejtesia.gov.al



MINISTRIA E DREJTËSISË
Koordinatori Kombëtar Kundër
Korrupsionit

MINISTRIA E DREJTËSISË

Koordinatori Kombëtar

Kundër Korrupsionit

Që prej vitit 2017, Ministria e Drejtësisë ka marrë rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK). Në këtë rol, Ministria e Drejtësisë koordinon të gjitha përpjekjet strategjike dhe të politikave bazuar në një qasje tri dimensionale: parandalimin, ndëshkimin, dhe ndërgjegjësimin.

Në kuadër të këtyre kompetencave, ky Fjalor ofron disa informacione thelbësore lidhur me korrupsionin.

Tabela e Përmbajtjes

Akronimet.....	8
Parathënie.....	9
Hyrje.....	10
Burimet.....	11
Përkufizimi dhe format e korrupsionit.....	14
Korrupsioni në sektorë të veçantë.....	17
Korrupsioni në organet ligjore dhe gjyqësore.....	17
Korrupsioni në sektorin e arsimit.....	18
Korrupsioni në sektorin e shëndetësisë.....	18
Korrupsioni në prokurimet publike.....	19
Korrupsioni në sport.....	19
Korrupsioni në sektorin privat.....	20
Korrupsioni në nivel të pushtetit vendor.....	20
Korrupsioni dhe partitë politike.....	20
Antikorrupsioni.....	21
A.....	22
Antikorrupsion	22
Auditim	22
DH.....	23
Dhënie e ryshfetit zyrtarëve publik	23
Dhënie e ryshfetit zyrtarëve publik të huaj dhe zyrtarëve të organizatave publike ndërkombëtare	23
Dhurata	23
F.....	24
Favorizim	24
Flukse të paligjshme financiare	24
Fshehje	24
I.....	25
Integritet	25
Integritet i institucioneve publike	25
K.....	25

Kapje e shtetit	25
Kërkesa	26
Kleptokraci	26
Klientelizëm	26
Konfiskim i aseteve	27
Konfiskim i pasurisë	27
Konflikt i interesit	27
Korrupsion aktiv	27
Korrupsion i madh	28
Korrupsion i vogël	28
Korrupsion në administratën publike	29
Korrupsion në sektorin privat	29
Korrupsion pasiv	29
Korrupsion politik	30
Korrupsion sistemik	30
Korrupsion sporadik	30
Kronizëm	30
L	31
Lobim	31
LI	31
Llogaridhënie	31
Llogaridhënie demokratike	32
M	32
Marrëveshje e fshehtë	32
Marrje e rentave, lobimi	32
Marrje e ryshfetit	33
Mashtrim	33
Matje e korrupsionit	33
Mbrojtje e sinjalizuesve	33
N	33
Ndërgjegjësim	33
Ndërrim i shpeshhtë i detyrave	34

Neopatrimonializëm.....	34
Nepotizëm.....	34
P.....	34
Pagesa lehtësuese.....	34
Pastrim i parave.....	35
Pastrim i produkteve të veprës penale.....	35
Pasuri e paligjshme.....	35
Patronazh politik.....	36
Përjashtim.....	36
Përvetësim.....	36
Përvetësim i pronave në sektorin privat.....	36
Plan i integritetit.....	37
Prokurim.....	37
Punëtorë fantazmë.....	37
Q.....	37
Qeverisje.....	38
R.....	38
Rikuperim i asetëve.....	38
Ryshfet.....	38
Ryshfet aktiv.....	39
Ryshfet komercial dhe shpërblime.....	39
Ryshfet në sektorin privat.....	39
Ryshfet pasiv.....	40
S.....	40
Sinjalizues.....	40
Sondazhe të perceptimit.....	40
Sondazhe të përvojave.....	40
SH.....	41
Shitblerje e informacionit.....	41
Shoqëri “guaskë”.....	41
Shpërblim.....	41
Shpërdorim i funksioneve apo detyrës.....	42

T.....	42
Tarifa dhe komisione	42
Transferta të kapitalit	42
Transparencë	43
Tolerancë zero	43
U.....	43
Ushtrim i ndikimit	43
V.....	44
Vepër penale e rëndë	44
Vigjilencë e duhur ndaj klientit	44
Vlerësim (i korrupsionit)	44
Vlerësim i rrezikut	44
Z.....	45
Zbatim	45
Zh.....	45
Zhvatje	45

Akronimet

BE	Bashkimi Evropian
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
KKKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
KKBK	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsioni

Parathënie

Lufta kundër korrupsionit është një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Qeveria Shqiptare mbështet çdo iniciativë që e gjykon të rëndësishme për nxitjen e integritetit në shoqëri dhe komunitet, duke vepruar në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi me objektivin kryesor për të parandaluar korrupsionin. Shqipëria ka pasur vazhdimisht përmirësime të dukshme në nismat e saj për ndërgjegjësimin ndaj korrupsionit. Krahas veprimeve në nivele legjislative dhe strategjike, lufta kundër korrupsionit përfshin një sërë qasjesh dhe mund të promovohet në mënyrë efektive si përmes bashkëpunimit ndërkombëtar ashtu edhe përmes edukimit, i cili përpiket të rrënjosë një kulturë kundër korrupsionit.

Ministri i Drejtësisë, i cili vepron në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, ka në fokus tre qasje për të luftuar korrupsionin: Parandalimin, Ndëshkimin dhe Ndërgjegjësimin.

Rrjeti i Koordinatorëve Kundër Korrupsionit nëpërmjet aktiviteteve të tij, synon të forcojë zbatimin e ligjit në institucionet që janë pjesë e Rrjetit Kundër Korrupsionit, me synim ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe punonjësve për rëndësinë e respektimit të normave juridike, shmangies së praktikave të papërshtatshme në kundërshtim me ligjin.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit ka si prioritet për Qeverinë Shqiptare sfidën e luftës kundër korrupsionit, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore për ta shndërruar angazhimin në veprim dhe veprimin në rezultat.

Ky fjalor është përgatitur nga Kontrata e Reformës Sektoriale për

Luftën kundër Korrupsionit e Delegacionit të Bashkimit Evropian, ndaj të cilit jemi jashtëzakonisht mirënjohës.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit,

Ministri i Drejtësisë

Hyrje

Korrupsioni rezulton të jetë një nga problemet më serioze për Shqipërinë, duke penguar zhvillimin e saj social-ekonomik, proceset e demokratizimit të vendit dhe marrëdhëniet me komunitetin ndërkombëtar, veçanërisht procesin e anëtarësimit të saj në BE. Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme, si dhe ka përditësuar vazhdimisht politikat e saj kundër korrupsionit në mënyrë që të adresojë problemin. Strategjia Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit, e cila është politika gjithëpërfshirëse e vendit kundër korrupsionit, përcakton objektivat që duhen arritur. Zbatimi dhe monitorimi kryhen nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Ky Fjalor është hartuar në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja, Asistencë Teknike për Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit – Kontrata e Reformës Sektoriale për Luftën kundër Korrupsionit dhe është botuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit të Shqipërisë.

Për të zbatuar një strategji kundër korrupsionit në një model të mirësynuar dhe për të menaxhuar integritetin në një mënyrë efikase, nevojitet të kuptohen bazat e korrupsionit dhe aftësia për të zbuluar forma të veçanta të tij në kontekste dhe lloje specifike të

veprimtarive të Qeverisë të përfshirë. Mbështetja e aspekteve specifike të përpjekjeve të Qeverisë dhe palëve të tjera të interesuara në përmbushjen e kërkesës për të punuar në mënyrën më efektive në luftën e përbashkët kundër korrupsionit.

Qëllimi kryesor i këtij Fjalori është të ofrojë shpjegimet bazë të termave që lidhen me korrupsionin dhe luftën kundër tij. Fjalori synon të shërbejë si një referencë e shpejtë dhe e besueshme jo vetëm për punonjësit e sektorit publik dhe politikëbërësit, por edhe për individët jashtë sektorit publik, të tillë si komuniteti i biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe media, me qëllim forcimin e njohurive ndaj simptomave, shkaqeve dhe efekteve të korrupsionit, si dhe strategjive të suksesshme për kundërveprimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Burimet

Fjalori bazohet kryesisht në materiale nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Këshilli i Evropës, Transparenca Ndërkombëtare, Qendra e Burimeve Kundër Korrupsionit U4, si edhe burime të tjera.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit është i vetmi instrument universal ligjërishit i detyrueshëm kundër korrupsionit. Qasja e gjerë e Konventës dhe karakteri i detyrueshëm i shumë prej dispozitave të saj e bëjnë atë një mjet unik për përpilimin e një përgjigjeje gjithëpërfshirëse ndaj një problemi global. Konventa mbulon pesë fusha kryesore: masat parandaluese,

kriminalizimin dhe zbatimin e ligjit, bashkëpunimin ndërkombëtar, rikuperimin e aseteve dhe asistencën teknike dhe shkëmbimin e informacionit. Konventa mbulon shumë forma të ndryshme të korrupsionit, të tilla si rryshfeti, ushtrimi i ndikimit, shpërdorimi i funksioneve dhe akte të ndryshme korrupsioni në sektorin privat. Konventa sjell vëmendje të veçantë tek rikuperimi i aseteve në një kapitull specifik, me synim kthimin e aseteve te pronarët e tyre të ligjshëm, duke përfshirë vendet nga të cilat ato janë marrë në mënyrë të paligjshme. Shumica dërmuese e Shteteve Anëtare të Kombeve të Bashkuara janë anëtarë të Konventës.

Këshilli i Evropës është një organizatë që kërkon të mbrojë demokracinë dhe të drejtat e njeriut, si dhe të promovojë unitetin ndërkombëtar me anë të nxitjes së bashkëpunimit për çështje ligjore, kulturore dhe sociale. Shqipëria u bë anëtare e Këshillit të Evropës më 13 korrik 1995 ku renditet vendi i 35-të. Këshilli i Evropës mbështet dhe promovon demokracinë pluraliste, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, si dhe merr në dorë luftën kundër korrupsionit duke qenë se ky i fundit përbën një kërcënim për vetë themelet e këtyre vlerave thelbësore. Në vitin 1999, Këshilli i Evropës themeloi Grupin e Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) i cili monitoron përputhshmërinë e Shteteve me standardet e organizatës kundër korrupsionit.¹ Objektivi i GRECO-s është përmirësimi i kapacitetit të anëtarëve të tij për të luftuar korrupsionin duke monitoruar përputhshmërinë e tyre me standardet kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës nëpërmjet një procesi dinamik të vlerësimit të ndërsjelltë dhe presionit të shteteve anëtare. Kjo sjell identifikimin e mangësive në politikat kombëtare kundër

¹ <https://www.coe.int/greco>

korrupsionit, duke nxitur reformat e nevojshme legislative, institucionale dhe praktike. GRECO ofron gjithashtu një platformë për shkëmbimin e praktikave më të mira për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit.²

Transparency International është një organizatë joqeveritare me seli në Gjermani e themeluar në vitin 1993 nga ish-punonjës të Bankës Botërore. Ajo ka evoluar në një lëvizje globale me qëllim ndërmarrjen e veprimeve për të luftuar korrupsionin global dhe për të parandaluar aktivitetet kriminale që burojnë nga korrupsioni. *Transparency International* punon për të ekspozuar sistemet dhe rrjetet që mundësojnë korrupsionin, duke kërkuar transparencë dhe integritet më të madh në të gjitha fushat e jetës publike nëpërmjet avokatisë, fushatës dhe hulumtimit. Ka krijuar qasjen e Sistemit Kombëtar të Integritetit si një mjet gjithëpërfshirës për vlerësimin e efikasitetit të vendit sektor pas sektori. Mundëson një analizë domethënëse të përpjekjeve kombëtare për të zhdukur korrupsionin. Ndër publikimet më të rëndësishme përmendim Barometrin Global të Korrupsionit dhe Indeks të Perceptimit të Korrupsionit, i cili cek renditjen e Shqipërisë.³

Qendra e Burimeve Kundër Korrupsionit U4 është një qendër e përhershme, e financuar nga donatorët, e cila promovon njohjen më të gjerë të çështjeve dhe qasjeve kundër korrupsionit në zhvillimin ndërkombëtar.⁴

BE-ja e sheh problemin e korrupsionit nga pikëpamja e mbrojtjes së

² <https://www.coe.int/en/>

³ <https://www.transparency.org/en/>

⁴ <https://www.u4.no/>

interesave financiare të komunitetit dhe respektimit të parimeve të konkurrencës si një komponent bazë të tregut të brendshëm. Raportet vjetore mbi ecurinë e procesit të anëtarësimit përmendin situatën e luftës kundër korrupsionit në vendet candidate të BE-së.⁵

Përkufizimi dhe format e korrupsionit

Etimologjia e fjalës korrupsion rrjedh nga latinishtja që do të thotë kalbëzim, vjetërsim, imoralitet ose pavërtetësi, ryshfetmarrje.

Nuk ka një përkufizim të vetëm të korrupsionit pavarësisht se korrupsioni është një term që përdoret shpesh në ligjëratat publike, politike dhe administrative.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (KKBK), që është i vetmi instrument universal ligjërsh i detyrueshëm kundër korrupsionit, nuk jep një përkufizim të tillë. Në vend të një përkufizimi të përgjithshëm ose veprës penale të korrupsionit, KKBK-ja përcakton standardet ndërkombëtare për kriminalizimin e korrupsionit duke përkrahur vepra të veçanta. Këto akte përfshijnë ryshfetin, përvetësimin, pastrimin e parave, fshehjen dhe pengimin e drejtësisë.

Konventat e Këshillit të Evropës dhe Organizatës për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD) kanë të njëjtën qasje.

Në vend të një përkufizimi të përgjithshëm ose veprës penale të korrupsionit, konventat përcaktojnë standardet ndërkombëtare për kriminalizimin e korrupsionit duke përkrahur vepra të veçanta.

Nga ana tjetër, përkufizimet e korrupsionit për qëllime politike janë

⁵ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report

shumë më të zakonshme.

Një përkufizim që përdoret shpesh dhe mbulon një gamë të gjerë aktiviteteve korruptive është "shpërdorimi i detyrës për përfitime personale". Ky përkufizim përdoret edhe nga BE-ja.⁶

Banka Botërore e përkufizon korrupsionin "si një formë mashtrimi ose një vepër penale që ndërmerret nga një person ose një organizatë të cilës i është besuar një detyrë autorizuese, me qëllim që të sigurojë përfitime të paligjshme ose të shpërdorojë detyrën për përfitime personale".⁷

Në një përkufizim alternativ, korrupsioni nënkupton "një formë të shkëmbimit të fshehtë shoqëror, nëpërmjet të cilit ata që janë në pushtet (politik ose administrativ) përfitojnë personalisht, të çfarëdo lloji, nga ndikimi që ata ushtrojnë në bazë të mandatit ose funksionit të tyre".⁸

Këto përkufizime mund të shërbejnë si një referencë e dobishme për hartimin e politikave dhe ndërgjegjësimin, si dhe për përpunimin e strategjive kundër korrupsionit, planeve të veprimit dhe masave për parandalimin e korrupsionit.

Për të kryer korrupsionin nevojiten elementët e mëposhtëm:

- a) një zyrtar (ose grup zyrtarësh) në sektorin publik (zyrtarë administrativë, politikanë, magistratë, punonjës në sferën buxhetore të ofrimit të shërbimeve, etj.);
- b) pushtet diskrecional (mundësia për të marrë vendime autonome sipas gjykimit të dikujt);

⁶ https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/corruption_en

⁷ Daniel Kaufmann dhe Pedro C. Vicente. "Korrupsioni ligjor". *Ekonomi & Politikë* 23.2 (2011): 195-219.

⁸ Amundsen, Inge. Korrupsioni politik: Një prezantim i çështjeve. Chr. Instituti Michelsen, 1999.

- c) shpërdorim të detyrës publike nga ana e zyrtarit;
- d) sigurim të përfitimeve personale ose grupore (financiare, materiale, favore) nga ana e zyrtarëve/zyrtarëve.

Kombinimi i ndryshëm i elementëve të lartpërmendur çon në lloje, forma, sfera, shkallë dhe mekanizma të ndryshëm të kryerjes së korrupsionit.

Llojet ose kategoritë më të zakonshme të korrupsionit janë korrupsioni nga pala ofruese kundrejt asaj marrëse, **korrupsioni i madh kundrejt korrupsionit të vogël** dhe korrupsioni publik kundrejt atij privat.

Korrupsioni i madh – aktivitete të padrejta të kryera nga zyrtarë të nivelit të lartë që mund marrin vendime dhe të ndajnë burime të konsiderueshme. Shumë shpesh korrupsioni “në shkallë të gjerë” shoqërohet me korrupsion në rangjet e larta të pushtetit. Në këtë rast, krerët e shteteve, zyrtarët e lartë publik dhe politikanët përdorin detyrën e tyre për të bërë përfitime të mëdha personale, politike ose korporative.

Korrupsioni i vogël përfshin ryshfet që u jepen zyrtarëve të zbatimit, personelit doganor, ofruesve të shërbimeve shëndetësore dhe zyrtarëve të tjerë qeveritarë, ndërsa korrupsioni i madh përfshin zyrtarë të rangut më të lartë qeveritar dhe zyrtarë të zgjedhur të cilët shfrytëzojnë mundësitë që u jepen përmes punës së qeverisë.

Korrupsioni nga pala ofruese përdoret për të përshkruar aktin e ofrimit të një pagese të paligjshme ose një përfitimi të padrejtë.

Korrupsioni nga pala marrëse lidhet me pranimin ose kërkesën e një pagese ose përfitimi të tillë. Korrupsioni aktiv dhe pasiv përdoret si sinonim me korrupsionin e ofertës dhe kërkesës.

Korrupsioni mund të dallohet edhe nga natyra e tij “publike” ose

“private” duke marrë parasysh sektorët në të cilët veprojnë pjesëmarrësit e aktit të paligjshëm. Korrupsioni aktiv përfshin një zyrtar publik si një palë në aktin korruptiv, ndërsa korrupsioni pasiv përfshin vetëm individë në sektorin privat, i cili quhet edhe “korrupsion pasiv në sektorin privat”.

Korrupsioni në sektorë të veçantë

Korrupsioni në organet ligjore dhe gjyqësore

Mundësitë për shpërdorim të detyrës në organet ligjore dhe gjyqësore (policia, shërbimi hetimor, prokuroria, gjykata) mund të lindin, por pa u kufizuar në situatat e mëposhtme:

- Identifikimi dhe regjistrimi i veprës ose krimi të kryer.
- Hartimi i deklaratave, vendosja e gjobave dhe llojeve të tjera të sanksioneve.
- Dhënia ose anulimi i lirimit me kusht.
- Ngritja e një aktakuze.
- Refuzimi për fillimin e procedurës paraprake.
- Anulimi i procedurës paraprak ose rikthimi në proces gjyqësor.

Korrupsioni në sistemin gjyqësor përfshin çdo ndikim të papërshtatshëm në objektivitetin e procedurave dhe gjykimeve gjyqësore dhe mund të shtrihet deri në dhënien e rryshfeteve të gjyqtarët që këto të fundit të marrin vendime të favorshme, ose të mos marrin asnjë lloj vendimi. Korrupsioni në sistemin gjyqësor

përfshin keqpërdorimin e fondeve dhe pushtetit gjyqësor, si p.sh. nëse një gjyqtar punëson anëtarë të familjes për stafin e gjykatës ose manipulon kontratat për ndërtimin dhe pajisjet e gjykatave. Mund të ndodhë gjithashtu që gjatë përzgjedhjes së njëanshme të çështjeve dhe procedurave të tjera para procesit gjyqësor, nëpunësit e korruptuar të gjykatës të "humbasin" dosjet dhe provat. Mund të ndikojë në çdo proces gjyqësor ose mbyllje të procesit gjyqësor, si dhe në zbatimin - ose jo - të vendimeve dhe dënimeve të proceseve gjyqësore.

Korrupsioni në sektorin e arsimit

Korrupsioni në arsim është përdorimi sistematik i funksioneve publike për përfitime personale, ndikimi i të cilit është i dukshëm në disponueshmërinë dhe cilësinë e përfitimeve dhe shërbimeve arsimore, si dhe në aksesin, cilësinë ose barazinë në arsim.⁹ Besohet se arsimi mund të veprojë si një nga shtyllat kryesore për nxitjen e një ndjeshmërie të re dhe një etike të zgjeruar kundër korrupsionit në Shqipëri, në të njëjtën mënyrë siç ka shërbyer nëpërmjet shumë shembujve të suksesshëm të vendeve që kanë luftuar për të dalë nga indiferenca mbizotëruese e publikut për çështjet e korrupsionit.

Korrupsioni në sektorin e shëndetësisë

Korrupsioni në sektorin e shëndetësisë shfaqet në shumë forma në fusha të ndryshme, të tilla si ndërtimi i objekteve shëndetësore; blerja e pajisjeve dhe furnizimeve; shpërndarja dhe përdorimi

⁹ Jacques Hallak dhe Muriel Poisson. "Etika dhe korrupsioni në arsim: një përmbledhje". Gazeta e arsimit për zhvillim ndërkombëtar 1.1 (2005): 1-3.

produkteve farmaceutike; arsimimi i punonjësve të sektorit përkatës; falsifikimi i hulumtimeve mjekësore; dhe ndoshta më e rëndësishmja për këtë raport, ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Korrupsioni në sektorin e shëndetësisë ka pasoja serioze për aksesin, cilësinë, barazinë, efikasitetin dhe përfitimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor – pesë dimensionet e performancës së sistemit shëndetësor. Çdo vit humbasin rreth 500 miliardë euro shpenzime për shëndetin publik në rang global për shkak të korrupsionit.¹⁰

Korrupsioni në prokurimet publike

Korrupsioni në prokurimin publik ndodh në rastet e keqpërdorimit të qartë të funksioneve publike. Së pari, veprimi duhet të jetë i qëllimshëm. Së dyti, personi duhet të ketë një përfitim të dukshëm nga akti. Së treti, përfitimi i marrë duhet të reflektohet menjëherë pas aktit të korrupsionit. Korrupsioni në prokurimin publik mund të jetë politik ose burokratik.

Korrupsioni në sport

Korrupsioni në sport përkufizohet si çdo aktivitet i paligjshëm, imoral ose jo etik që tenton të pengojë qëllimisht rezultatin e një gare sportive për përfitime materiale të një ose më shumë palëve të përfshira në atë aktivitet.¹¹

¹⁰ <https://www.transparency.org/en/our-priorities/health-and-corruption>

¹¹ Eddie TC. Lam. "Korrupsioni në sport: Shkaqet, Pasojat dhe Reforma." *Gazeta Ndërkombëtare për Komunikimet Sportive* 12, nr. 1 (2019)

Korrupsioni në sektorin privat

Korrupsioni nuk kufizohet vetëm në sektorin publik. Është një problem që prek edhe shoqëritë private të të gjitha përmasave. Shoqëritë mund të jenë edhe viktima edhe autorë të korrupsionit. Në një kontekst biznesi, korrupsioni mund të përfshijë raport financiar të rremë ose mashtrues, mashtrim në prokurime, përvetësim, ryshfet dhe një sërë aktesh të tjera.

Korrupsioni në nivel të pushtetit vendor

Pushteti vendor është gjithashtu e ekspozuar ndaj korrupsionit duke qenë se përfshin shumë funksione në sektorë të ndryshëm të qeverisë—të tilla si arsimi, shërbimet sociale, transporti, ndërtimi, zgjedhjet dhe mbledhja e taksave. Megjithatë, pushtetet vendore mund të jenë më të ndjeshme ndaj korrupsionit duke qenë se individët privatë dhe zyrtarët bashkëveprojnë ngushtë me njëri tjetrin dhe herë pas here në nivele të decentralizuara. Format e korrupsionit që kanë të bëjnë me paratë si ryshfeti, zhvatja, përvetësimi, nepotizmi dhe patronazhi hasen shpesh në sistemet e qeverisjes vendore.

Korrupsioni dhe partitë politike

Ekzistenca e praktikave të korrupsionit në jetën politike rezulton nga akumulimi i pushtetit, i cili si rregull i përket gjithë shoqërisë, mirëpo në fakt është i përqendruar në një grup të caktuar njerëzish (elita

politike dhe partiake). Ata që drejtojnë vendin mund të vendosin vetë se si të veprojnë duke përfituar nga e drejta për të kontrolluar atë burim publik të pushtetit.

Korrupsioni politik ndryshon nga korrupsioni në administratën publike në çështjet, përfitimet dhe efektet e tij specifike. Në rastin e korrupsionit politik, përfitimet nuk interpretohen gjithmonë si para, por shumë shpesh ato kanë të bëjnë me shmangien e procesit politik demokratik (përfaqësimi, llogaridhënia, transparenca, barazia para ligjit). Keqpërdorimet në këtë rast përfshijnë gjithashtu rishpërndarjen e burimeve në favor të një partie të caktuar ose një grupi shoqëror. Kjo buron nga kontrolli i ushtruar i elitës partiake-politike mbi legjislacionin dhe proceset politike.

Antikorrupsioni

Antikorrupsioni përbëhet nga aktivitete që kundërshtojnë ose frenojnë zhvillimin e korrupsionit. Përpjekjet kundër korrupsionit ndryshojnë si në fushëveprim ashtu dhe në strategji, njësoj si korrupsioni që merr forma të shumta. Shpesh bëhet një dallim i përgjithshëm ndërmjet masave parandaluese dhe shtypëse, ose ndëshkuese.

Parandalimi i korrupsionit shpesh përfshin:

- Miratimin e politikave të dobishme dhe të koordinuara antikorruptive
- Forcimin e integritetit të sektorit publik¹²

¹² Shihni Planet e Integritetit të Shqipërisë në nivel lokal dhe qendror në faqen e internetit të KKK-së

- Rritjen e transparencës së institucioneve publike
- Krijimin e një sistemi të drejtë dhe transparent të prokurime publike
- Ndërgjegjësimin e qytetarëve për shmangien e përfshirjes në korrupsion dhe raportimin e rasteve të korrupsionit që ata hasin

Ndëshkimi i korrupsionit çon në hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, duke përfshirë konfiskimin e asetëve që vijnë nga korrupsioni dhe mbrojtja e drejtësisë sociale.

Informacioni mbi përpjekjet që ka bërë Shqipëria për luftën kundër korrupsionit mund të gjendet në faqen e internetit të Qeverisë: <http://drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-kunder-korrupsionit/>

A

Antikorrupsion

Ky term përdoret për të përcaktuar gamën e qasjeve që nevojiten për të luftuar korrupsionin. Shumë qasje më gjithëpërfshirëse të qeverisjes së mirë dhe promovimit të demokracisë japin fryte të ngjashme, edhe nëse ato nuk janë etiketuar në mënyrë të qartë si "antikorrupsion".

Auditim

Një kontroll zyrtar i llogarive të një organizate (të sektorit publik ose privat) për t'u siguruar që paratë shpenzohen dhe raportohen siç duhet.

Dhënie e ryshfetit zyrtarëve publik

Premtimi, ofrimi ose dhënia e një avantazhi të padrejtë një zyrtari publik, ose kërkimi ose pranimi i këtij avantazhi nga një zyrtar i tillë. Kjo mund të ndodhë drejtpërdrejt ose tërthorazi dhe ryshfetet mund t'i jepen atyre ose një personi tjetër. Synimi është që zyrtari të kryejë ose të përmbahet nga kryerja e detyrave të tij zyrtare.

Dhënie e ryshfetit zyrtarëve publik të huaj dhe zyrtarëve të organizatave publike ndërkombëtare

Premtimi, ofrimi ose dhënia e një avantazhi të padrejtë një zyrtari publik të huaj ose një zyrtari të një organizate publike ndërkombëtare, ose kërkimi ose pranimi i këtij avantazhi nga një zyrtar i tillë. Kjo mund të ndodhë drejtpërdrejt ose tërthorazi dhe ryshfetet mund t'i jepen atyre ose një personi tjetër. Qëllimi është që zyrtari të kryejë ose të përmbahet nga kryerja e detyrave të tij zyrtare në mënyrë që shkelësi të fitojë ose të mbajë biznesin ndërkombëtar ose një avantazh tjetër të padrejtë.

Dhurata

Njerëzit japin dhurata dhe ofrojnë favore në rrethana të ndryshme. Është një zakon kulturor në shumë shoqëri. Problemet lindin kur dhënia e dhuratave për dhe nga zyrtarët publik bie në kundërshtim me paanshmërinë, profesionalizmin dhe meritokracinë. Në këmbim të një dhurate, zyrtari pritët të trajtojë në mënyrë preferenciale personin që i ka dhuruar diçka. Në ato raste, dhënia e dhuratave mund të konsiderohet si ryshfet, aktivitet kriminal dhe përpjekje për

të fshehur pasurinë nga autoritetet tatimore.

Dhuratat dhe mikpritja e tepërt u jepen punonjësve për të ndikuar në vendimet dhe detyrat e biznesit. Kjo lloj dhurate mund të jetë në formën e udhëtimeve, sendeve luksoze ose biletave për evente sportive.

F

Favorizim

Shpërndarja e njëanshme e burimeve duke u bazuar në preferencat personale. Për shembull, dhënia e pozicioneve të punës ose përfitimeve për miqtë dhe familjen, pavarësisht kualifikimit. Shpërndarja e padrejtë e detyrave dhe burimeve njihet gjithashtu si kronizëm ose nepotizëm.

Flukse të paligjshme financiare

Flukset e paligjshme financiare përfshijnë transferimin ndërkufitar të parave të fituara nëpërmjet aktiviteteve të paligjshme. Këto aktivitete përfshijnë korrupsionin, aktivitetet kriminale dhe përpjekjet për të fshehur pasurinë nga autoritetet tatimore.

Fshehje

Fshehja e qëllimshme ose mbajtja e vazhdueshme e pasurisë ndodh kur personi është në dijeni që kjo pasuri rezulton nga veprat penale të korrupsionit, edhe kur ai/ajo nuk ka marrë pjesë në këto vepra.

Integritet

Integritet nënkupton ndjekjen e një sërë parimesh morale ose etike. Ai vlerëson “shtyllat” kyçe në sistemin e qeverisjes së një vendi, për sa i përket rreziqeve të brendshme të korrupsionit dhe kontributit të tyre në luftën kundër korrupsionit në shoqërinë në përgjithësi. Kur të gjitha shtyllat funksionojnë mirë, korrupsioni mbetet nën kontroll. Në rastet ku disa ose të gjitha shtyllat janë të dobëta, kjo i jep mundësinë korrupsionit të lulëzojë.

Integritet i institucioneve publike

Integriteti i institucioneve publike është disponimi i fuqishëm i një institucioni publik për të ndjekur në mënyrë rigorozë qëllimin e tij legjitim, me kapacitetet më të mira dhe në përputhje me angazhimet e tij.

Kapje e shtetit

Individë, grupe dhe organizata të fuqishme që formojnë në rrugë jodemokratike politikën, institucionet ligjore dhe ekonominë e një kombi për tu pasuruar në mënyrë të paligjshme pa qenë subjekt i ndëshkimeve. Ky është një lloj korrupsioni i madh që ndodh kur shoqëritë apo organizatat formojnë dhe ndikojnë në legjislativën apo politikën e qeverisë në të gjithë sektorin nëpërmjet pagesave. Për shembull, bizneset mund të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme ligjvënësit që të miratojnë ligje të favorshme.

Kërkesa

Kjo ndodh kur një punonjës i një shoqërie kërkon një pagesë, avantazh të padrejtë, dhurata të shtrenjta ose favore seksuale në këmbim të kryerjes së detyrave specifike që lidhen me biznesin ose marrjen e vendimeve të veçanta.

Kleptokraci

Një fjalë greke që nënkupton "sundim nga hajdutët", kleptokracia i referohet një sistemi qeverisjeje në të cilin udhëheqësit përdorin detyrën e tyre për përfitime personale në kurriz të qytetarëve. Zakonisht lidhet me regjimet autokratike pa mekanizma kuptimplotë të llogaridhënies, duke lejuar efektivisht liderin të vjedhë shtetin dhe qytetarët e tij për pasurim personal dhe të forcojë kompetencat e tij. Disa ish-kleptokratë të njohur janë Francois Duvalier ("Papa Doc") nga Haiti, Mobutu nga Zaire dhe Suharto nga Indonezia.

Klientelizëm

Një sistem informal që shfrytëzon shkëmbimet (burimesh, shërbimesh, favoresh) ndërmjet një "shefi" ose "bosi" më të pasur dhe/ose më të fuqishëm dhe "klientëve" ose "ndjekësve" më pak të pasur/të dobët. Këto sisteme zakonisht gjenden në mjedise ku strukturat formale të qeverisjes nuk arrijnë të ofrojnë burime të përshtatshme (duke përfshirë mbrojtjen), duke bërë që anëtarët e varfër dhe/ose të marginalizuar të shoqërisë të kërkojnë ndihmë nga njerëz të fuqishëm që mund t'i ofrojnë ato. Dimensionin e korrupsionit shihet qartë kur "shefi" është një zyrtar i zgjedhur që shpërndan burimet nën kontrollin e tij/saj në mënyrë të padrejtë (duke abuzuar

me pushtetin e besuar), si shpërblim për mbështetjen gjatë zgjedhjeve (përfitim privat). Sisteme të ngjashme informale mund të mos përfshijnë zyrtarë të zgjedhur drejtpërdrejt, por megjithatë mund të dëmtojnë rregullat dhe institucionet formale, duke përfshirë përpjekjet për të luftuar korrupsionin.

Konfiskim i asetëve

Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave të veprës penale, ndodh për shkak se ato janë përdorur në kryerjen e krimit, ose përftohen prej tij.

Konfiskim i pasurisë

Humbja, pas një dënimi penal, e së drejtës për një pronë që është përdorur për kryerjen e një krimi dhe e cila është konfiskuar nga qeveria.

Konflikt i interesit

Konflikti i interesit është një konflikt ndërmjet një detyre të besuar nga njëra anë dhe interesit privat të personit në detyrë nga ana tjetër. Për shembull, një anëtar i parlamentit në komisionin për reformën e kujdesit shëndetësor mund të zotërojë aksione në një shoqëri të madhe farmaceutike. Prania e këtij interesi privat mund të ndikojë në kryerjen jo të duhur të përgjegjësive të besuara. Konfliktet e interesit duhet të shmangen ose të menaxhohen sepse krijojnë mundësi për korrupsion.

Korrupsion aktiv

Premtimi, ofrimi ose dhënia, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të

tërthortë, e çdo avantazhi të padrejtë për një zyrtar publik për veten e tij ose për dikë tjetër që të veprojë ose të përmbahet nga veprimi në shkelje të detyrave të tij.

Korrupsion i madh

Kjo përfshin zyrtarë qeveritarë të nivelit më të lartë dhe zyrtarë të zgjedhur që marrin vendime dhe të alokojnë burime të rëndësishme që shfrytëzojnë mundësitë që paraqiten përmes punës së qeverisë. Në këtë rast, administratorët e lartë dhe politikanët përdorin detyrën e tyre për të bërë përfitime të mëdha personale, politike ose korporative. Ky lloj korrupsioni përfshin funksionimin e mekanizmave më kompleksë dhe më të mirë ku ndërmjetësit luajnë një rol kyç. Duke qenë se abuzimet dhe përfitimet e marra, si dhe efektet sociale dhe ekonomike janë në numër të madh, nuk ka një kufi të qartë ndërmjet formës aktive dhe pasive të tij.

Korrupsion i vogël

Aktivitete të padrejta të kryera nga administratorë të niveli më të ulët duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, klientët dhe sipërmarrjet. Në këtë rast, përfitimet (pagesa, dhurata, favore) janë më të pakta në vlerë, por të shpeshta dhe merren çdo ditë. Korrupsioni mund të kryhet në disa mënyra

- Zyrtari deklaron drejtpërdrejt “çmimin” për aktivitetin ose favorin e kërkuar;
- Zyrtari nuk deklaron drejtpërdrejt se ai/ajo kërkon rryshfet, por vendos pengesa zyrtare dhe joformale, “nënkupton” se problemi mund të zgjidhet, duke e detyruar palën tjetër të sugjerojë një “alternativë korruptive”;

- Personi që dëshiron të marrë një lloj favori deklaron drejtpërdrejt një “shpërblim” korruptiv ndaj një zyrtari përkatës.

Korrupsion në administratën publike

Korrupsioni që ndodh në pikëtakimin ndërmjet shtetit, që përfaqësohet nga zyrtarë publik/burokratë të cilët kanë funksione vendimmarrëse dhe publikut/qytetarëve duke qenë se ata kanë nevojë për një shërbim.

Korrupsion në sektorin privat

Abuzimi i detyrave profesionale në një korporatë ose subjekt tjetër joqeveritar për përfitime personale. Për shembull, korrupsioni në sektorin privat ndodh kur një punonjës i korporatës i shet sekretet tregtare një konkurrenti. Gjithashtu, termi përdoret më gjerësisht për rastet kur individë ose grupe nga sektori privat ushtrojnë ndikim tek zyrtarët publik për të marrë vendime dhe veprime që përbëjnë abuzim me pushtetin e besuar. Një shembull janë korporatat që u ofrojnë ryshfet zyrtarëve publik në këmbim të legjislacionit të favorshëm ose kontratave fitimprurëse.

Korrupsion pasiv

Kërkesa ose marrja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga çdo zyrtar publik i ndonjë avantazhi të padrejtë, që nuk i takon, për vete ose për dikë tjetër, apo pranimi i një oferte ose një premtimi për këtë avantazh, për të vepruar ose për të mos vepruar në përputhje ose në kundërshtim me detyrat e tyre.

Korrupsion politik

Termi përdoret ngushtësisht për të përcaktuar manipulimin e politikave, institucioneve dhe rregullave në financimin e partive politike në fushatat elektorale, dhe më gjerësisht si sinonim për "korrupsionin e madh", ose korrupsionin që haset në nivelet më të larta të qeverisë ku hartohen politika, rregulla dhe merren vendime ekzekutive. Korrupsioni politik ndodh kur vendimmarrësit politikë përdorin pushtetin politik me të cilin janë deleguar, për të mbajtur pushtetin, statusin dhe pasurinë e tyre. Për shkak të seriozitetit dhe nivelit të lartë të zyrtarëve publik të përfshirë, konsiderohet si një lloj korrupsioni i madh.

Korrupsion sistematik

Një situatë kur korrupsioni është një pjesë përbërëse e sistemit ekonomik, social dhe politik të një shteti dhe ku pjesa më e madhe e njerëzve nuk kanë zgjedhje tjetër vetëm të merren me zyrtarët e korruptuar. Në të kundërt, korrupsioni sporadik ndodh në mënyrë të parregullt dhe nuk është aq i rrezikshëm për mekanizmat e qeverisjes.

Korrupsion sporadik

Korrupsioni sporadik është e kundërta e korrupsionit sistematik. Duke qenë se ndodh në mënyrë të parregullt, nuk kërcënon mekanizmat e kontrollit dhe as ekonominë. Nuk shkakton probleme të mëdha, por mund të dëmtojë rëndë moralin dhe ekonominë e burimeve.

Kronizëm

Trajtimi i favorshëm i miqve dhe bashkëpunëtorëve në shpërndarjen

e burimeve dhe detyrave. Koncepti ka të bëjë me nepotizmin, ku trajtimi i favorshëm përfshin edhe anëtarët e familjes.

L

Lobim

Çdo aktivitet që kryhet për të ndikuar në politikat dhe vendimet e një qeverie ose institucioni në favor të një kauze ose rezultati specifik. Lobimi është një mjet i rëndësishëm për palët e interesuara që zëri i tyre të dëgjohet nga politikanët dhe zyrtarët publik. Qytetarët angazhohen në lobim kur i shkruajnë përfaqësuesit të tyre të zgjedhur ose i bashkohen një proteste, etj. Nga ana tjetër, lobistët profesionistë paguhen për të mbrojtur interesat specifike të klientëve të tyre përpara zyrtarëve publik përgjegjës. Ndonjëherë, ata janë ish-zyrtarë, të punësuar për njohuritë rreth problemeve dhe kontakteve në këtë sektor. Por kushtet e angazhimit të ish-zyrtarëve publik janë zakonisht të qarta dhe të kufizuara për të veçuar lobimin e lejuar nga ushtrimi i ndikimit të paligjshëm.

LI

Llogaridhënie

Detyrimi i një individi ose një organizate (qoftë në sektorin publik ose privat) për të pranuar përgjegjësinë për aktivitetet e tyre dhe për t'i shpalosur ato në mënyrë transparente. Kjo përfshin përgjegjësinë për proceset e vendimmarrjes, paratë ose pasuritë e tjera të besuara.

Llogaridhënie demokratike

Llogaridhënia demokratike i referohet idesë që qytetarët mund të japin reagime për aktorët (partitë politike, parlamentet, zyrtarët publik) që janë përgjegjës për përcaktimin e politikave dhe vendimmarrjen dhe në këtë mënyrë i japin formë politikave dhe vendimeve.

M

Marrëveshje e fshehtë

Marrëveshja e fshehtë i referohet marrëveshjes dhe bashkëpunimit të fshehtë ndërmjet palëve të interesuara për një qëllim mashtrues, çorientues ose i paligjshëm.

Marrje e rentave, lobimi

Marrja e rentave nënkupton lobimin e qeverisë për mbrojtje, subvencione dhe politika preferenciale për një biznes. Synimi është shmangia e konkurrencës në tregun e lirë dhe arritja e kushteve të ngjashme me monopolin dhe përfitimet jashtëzakonisht të mëdha (rentat). Marrja e rentave shkakton reduktimin e efikasitetit ekonomik përmes shpërndarjes së gabuar të burimeve, reduktimit të krijimit të pasurisë, humbjes së të ardhurave të qeverisë dhe rritjes së pabarazisë së të ardhurave. Ndryshe nga marrja e përfitimeve me mjetet e tregut, marrja e rentave me mjete politike nuk krijon pasuri; ajo thjesht transferon privilegjin nga njëra palë te tjetra. Lobimi shpesh përfshin korrupsionin e zyrtarëve publik dhe politikanëve – domethënë praktika korruptive.

Marrje e ryshfetit

Marrja e ryshfetit (e njohur edhe si ryshfet "pasiv") fokusohet tek personi ose subjekti që kërkon ose merr ryshfet.

Mashtrim

Një krim ekonomik që përfshin çorientimin, mashtrimin ose pretendimet e rreme me anë të të cilave dikush fiton në mënyrë të paligjshme. Shpesh herë, aktet korruptive ndiqen edhe nga mashtrimi, në veçanti përvetësimi, ku zakonisht përdoret për të falsifikuar të dhënat që të fshihen burimet e vjedhura.

Matje e korrupsionit

Ekzistojnë dy qasje kryesore për vlerësimin e korrupsionit. Njëra qasje është matja, e cila synon të përcaktojë shtrirjen e korrupsionit. Qasja tjetër është vlerësimi, i cili kërkon të identifikojë faktorët që bëjnë të mundur korrupsionin.

Mbrojtje e sinjalizuesve

Mbrojtja e sinjalizuesve i referohet masave të marra për të mbrojtur zyrtarin që raporton shkeljen nga hakmarrja.

N

Ndërgjegjësim

Ndërgjegjësimi është një proces që përpiqet të informojë dhe edukojë njerëzit rreth një teme ose çështjeje me synim ndikimin në qëndrimet, sjelljet dhe besimet e tyre drejt arritjes së një qëllimi ose

objektivi të përcaktuar.¹³ Ndërgjegjësimi synon të vë në lëvizje fuqinë e opinionit publik në mbështetje të një çështjeje dhe në këtë mënyrë të ndikojë në vullnetin politik të vendimmarrësve.

Ndërrim i shpeshtë i detyrave

Ndërrimi i shpeshtë i detyrave i referohet lëvizjeve të individëve nga puna si ligjvënës ose rregullator në shoqëri ose firma lobimi që janë subjekt i legjislacionit dhe rregullores. Mund të ketë abuzime nëse nuk rregullohet siç duhet.

Neopatrimonializëm

Një lloj qeverisjeje e bazuar në marrëdhëniet informale shef-klient, ku elita përdor burime shtetërore, të mirat dhe pozicionet publike për të siguruar besnikërinë nga popullsia në përgjithësi.

Nepotizëm

Një formë favorizimi që përfshin marrëdhëniet familjare, ku një person shfrytëzon autoritetin e tij/saj për të siguruar vende pune ose favore të tjera për të afërmit. Kur ky trajtim përfshin edhe miqtë dhe bashkëpunëtorët, termi i përshtatshëm është kronizëm.

P

Pagesa lehtësuese

I referohen shumave relativisht të vogla individuale të paguara përtej

¹³ Richard Sayers. Parimet e ndërgjegjësimit. UNESCO 2006.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001476/147637e.pdf>

tarifave zyrtare për të përshpejtuar shërbimet si zhdoganimi, lejet e punës, kalimet në kufi etj. Nga ana teknike, këto konsiderohen rryshfete. Megjithatë, në shumë vende, pagesat lehtësuese nga shoqëritë që bëjnë biznes jashtë vendit nuk janë subjekt i ndjekjes penale për rryshfet në vendet e tyre për sa kohë që ato përdoren për të përshpejtuar proceset ligjore, në vend që të shmangin rregulloret. Ky përjashtim njeh faktin se në kushte të caktuara, është e pamundur të operosh një biznes pa bërë këto pagesa.

Pastrim i parave

Çdo akt ose akt në tentativë që fsheh burimin e parave ose pasurive të përfituara nga korrupsioni ose veprimtari të tjera kriminale. Pastrimi i parave përfshin fshehjen e origjinës dhe përdorimin e pasurive të paligjshme. Shpesh përdoret për të fshehur të ardhurat që vijnë nga korrupsioni, si dhe të ardhurat nga lloje të tjera të krimit ekonomik.

Pastrim i produkteve të veprës penale

Konvertimi, fshehja ose transferimi i pasurisë së fituar nga paratë e fituara në rrugë të paligjshme duke e bërë atë të duket sikur është fituar në mënyrë të ligjshme.

Pasuri e paligjshme

Një rritje e konsiderueshme e pasurisë së një zyrtari publik që nuk mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme si rezultat i të ardhurave të tij/saj të ligjshme.

Patronazh politik

Patronazhi politik është përdorimi i burimeve shtetërore si shpërblim për individët për mbështetjen e tyre politike dhe elektorale. Patronazhi politik cenon kufijtë e ndikimit legjitim politik dhe parimet e meritës.

Përrjashtim

Përrjashtimi është termi që përdoret për një individ ose një shoqëri që përrjashtohet zyrtarisht nga tender për një projekt që financohet ose mbështetet nga qeveria. Shoqëria përrjashtohet kur nga hetimi ose kontrolli zbulohet se ajo është përrfshirë në mashtrim, keqmenaxhim ose korrupsion.

Përrvetësim

Përrvetësimi ose keqpërrdorimi i qëllimshëm nga një zyrtar publik i pasurisë, fondeve ose çdo gjëje me vlerë që iu ishte besuar për shkak të detyrës së tyre. Kontabilistët dhe menaxherët e financave zakonisht kanë akses në fondet e një agjencie dhe në këtë mënyrë mund t'i përrvetësojnë ato. Forma të tjera të përrvetësimit janë marrja e furnizimeve, pajisjeve, etj.

Përrvetësim i pronave në sektorin privat

Përrvetësimi nga çdo person që menaxhon ose punon, drejtpërrdrejt ose tërrthorazi, në çdo pozicion, për një subjekt të sektorit privat.

Plan i integritetit

Plani i integritetit është një mjet që shërben për përcaktimin dhe verifikimin e integritetit të organizatës. Është një proces i dokumentuar për vlerësimin e nivelit të cenueshmërisë së një organizate, ekspozimit të saj ndaj praktikave joetike dhe korrupsionit. Ky plan ndihmon institucionet individuale të vlerësojnë rreziqet e korrupsionit dhe t'i menaxhojnë ato në mënyrë efikase. Qëllimi kryesor i planit të integritetit është të forcojë integritetin dhe kulturën kundër korrupsionit në një sektor publik duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave të përshtatshme.

Prokurim

Prokurimi i referohet fazave të ndryshme të blerjes së mallrave ose shërbimeve nga një burim i jashtëm dhe ku blerësit (siç janë institucionet dhe organizatat publike), shpesh në një proces tenderimi, kërkojnë ofertën më të mirë në vlerë monetare për mallrat dhe shërbimet që duhet të prokurohen.

Punëtorë fantazmë

Punonjësit që figurojnë në listën e pagave, por në të vërtetë nuk punojnë për shoqërinë ose institucionin publik. Çeqet e pagesës krijohen dhe paguhen për dikë që nuk punon për shoqërinë ose institucionin publik ose që nuk ekziston fare.

Q

Qeverisje

Qeverisja shkon përtej koncepteve të zakonshme të qeverisjes. Ajo fokusohet në marrëdhëniet ndërmjet liderëve, institucioneve publike dhe qytetarëve. Përfshin proceset e vendimmarrjes dhe zbatimit. Mund të zbatohet edhe për shoqëritë dhe OJQ-të.

R

Rikuperim i asetëve

Rikuperimi i asetëve, siç përshkruhet në Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit, nënkupton procesin me anë të të cilit të ardhurat nga korrupsioni që janë transferuar jashtë rikuperohen dhe riatdhesohen në vendin nga i cili janë marrë ose te pronarët e tyre të ligjshëm.

Ryshfet

Oferta ose shkëmbimi i parave, shërbimeve apo sendeve të tjera me vlerë për të ndikuar në gjykimin ose punësimin e një personi me pushtet të besuar. Kjo nuk nënkupton përfitimin e drejtpërdrejtë të zyrtarit në fjalë – në këtë rast mund të jetë bashkëshorti/ja, fëmija, një i/e afërm/e, një mik/eshë, apo edhe një parti politike e zyrtarit e cila merr një donacion. Një ryshfet ndonjëherë është një pagesë me këste mujore që i bëhet një zyrtari i cili ka dhënë leje shitësve ambulante të operojnë nëpër rrugë. Kjo formë e ryshfetit quhet shpërblim. Ryshfeti kriminalizohet gjerësisht, dhe njësoj si pala që paguan ryshfetin ashtu edhe pala që e merr atë mund të jenë përgjegjëse (shihni ryshfeti aktiv/ ryshfet pasiv). E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kriminalizimin e pagesave lehtësuese që ndodhin në sektorin privat.

Ryshfet aktiv

Ryshfeti aktiv nënkupton aktin e premtimit ose dhënies së ryshfetit, ndryshe nga akti i marrjes së ryshfetit (ryshfeti pasiv). Termi nuk do të thotë se dhënësi aktiv i ryshfetit ka marrë iniciativën, pasi ryshfeti mund të jetë kërkuar nga pala marrëse (e cila kryen “ryshfet pasiv”). Një qytetar që bën një pagesë informale pa dëshirën e tij/saj për të marrë kujdesin mjekësor, përndryshe i refuzohet, ai/ajo sidoqoftë kryen ryshfet aktiv. Dallimi midis ryshfetit aktiv dhe pasiv bëhet kryesisht në përkufizimet ligjore, të cilat duhet të jenë të sakta dhe të lejojnë mundësinë e sanksionimit të secilës palë të transaksionit, sipas rastit. Ka një ngjashmëri me klasifikimin midis korrupsionit nga pala ofruese dhe ajo marrëse, i cili përdoret në analizimin e modeleve të stimujve ose nxitësve të praktikave korruptive.

Ryshfet komercial dhe shpërblime

Këto përfshijnë punonjësit e një shoqërie që japin pagesa, avantazhe të panevojshme ose dhurata të shtrenjta për punonjësit e një shoqërie tjetër për të siguruar një avantazh. Disa shembuj janë pagesa e stafit të prokurimit për të ndikuar në vendimin e tyre në favor të shoqërisë paguese, dhënia e një dhurate të shtrenjtë menaxherit të bankës për të siguruar një kredi, dhe forma të ndryshme shpërblimesh.

Ryshfet në sektorin privat

Ryshfeti aktiv ose pasiv nga çdo person që menaxhon ose punon, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në çfarëdo detyre, për një subjekt të sektorit privat.

Ryshfet pasiv

I referohet aktit të marrjes së ryshfetit. Kjo nuk nënkupton se dhënësi i ryshfetit pasiv nuk është ofruar i pari, në shumë raste ai ose ajo mund të ketë kërkuar ryshfet i/e pari.

S

Sinjalizues

Sinjalizuesit janë personat që informojnë publikun ose autoritetet për transaksione korruptive dhe/ose sjellje të tjera të paligjshme ose imorale që ata kanë parë ose zbuluar. Këta individë shpesh kërkojnë që tu ofrohet mbrojtje ndaj personave që ekspozojnë.

Sondazhe të perceptimit

Pyetësorë ku bëhen pyetje për pikëpamjet e të anketuarve mbi nivelet e korrupsionit në një vend/sector/institucion, dhe ndonjëherë përshtypjen e tij/saj nëse situata po ndryshon për mirë apo për keq.

Sondazhe të përvojave

Pyetësorë ku bëhen pyetje për rastet e drejtpërdrejta me korrupsionin, për shembull: - nëse të anketuarve u është dashur të paguajnë ryshfet për një shërbim të caktuar publik; - sa herë kanë dhënë ryshfet vitin e kaluar; - shumën e ryshfetit të paguar.

Shitblerje e informacionit

Kjo ndodh kur një punonjës që punon në biznes ofron ose merr një ryshfet në këmbim të informacionit konfidencial, ku ryshfeti mund të ndodhë në disa forma të ndryshme. Kur informacioni konfidencial përbën bazën për tregtimin e aksioneve, obligacioneve ose titujve të tjerë të një shoqërie, kjo përbën një shkelje që quhet "shitblerje në rreth të brendshëm".

Shoqëri “guaskë”

Shoqëria “guaskë” është një shoqëri jotregtare, e cila përdoret si mjet për operacione të ndryshme financiare, qëllime të paligjshme ose që mbahet si shoqëri joaktive për përdorim në të ardhmen në ndonjë funksion tjetër. Zakonisht, shoqëritë “guaskë” themelohen në një juridiksion në të cilin nuk kërkohet prania fizike dhe nuk është e lidhur me një grup të rregulluar.

Shpërblim

Një ryshfet i paguar pas favorit ose shërbimit të padrejtë. Për shembull, një shoqëri që nënshkruan një kontratë qeveritare mund t'i dërgojë zyrtarit përgjegjës pagesa të rregullta për kohëzgjatjen e kontratës. Shitësit ambulantë mund t'i paguajnë autoritetit që jep leje një shumë të vogël çdo muaj për sa kohë që ata lejohen të operojnë.

Shpërdorim i funksioneve apo detyrës

Abuzimi i qëllimshëm i një zyrtari publik me funksionet ose detyrën e tij për të vepruar ose mos-vepruar një akt të paligjshëm. Synimi është përfitimi personal ose për një person tjetër.

T

Tarifa dhe komisione

Tarifat dhe komisionet përbëjnë dhënien e një avantazhi financiar, megjithëse nuk është detyrimisht rryshfet. Një komision është i paligjshëm nëse është një pagesë lehtësuese për kryerjen (ose kryerjen më të shpejtë) të një detyre aktuale.

Veçimi i një pagese si tarifë ose komision mund të jetë një mënyrë për të fshehur pagesën e një rryshfeti.

Transferta të kapitalit

Qarkullimi i shumave të mëdha të parave jashtë një vendi. Ky qarkullim mund të jetë i ligjshëm (për shembull investitorët tërheqin paratë e tyre për shkak të një krize politike dhe mungesës së besimit në situatën ekonomike) ose i paligjshëm. Transferta e paligjshme e kapitalit shpesh ka të bëjë me paratë e fituara përmes veprimtarisë kriminale dhe qëllimi është që paratë të fshihen nga çdo dokument në vendin e origjinës. Të ardhurat që burojnë nga kjo lloj transferte zakonisht nuk kthehen në vendin e origjinës.

Transparencë

Transparenca është vlera e të qenit i hapur, i komunikueshëm dhe i përgjegjshëm. Kjo nënkupton që qeveritë dhe agjencitë e tjera kanë për detyrë të veprojnë në mënyrë të dukshme dhe të kuptueshme. Transparenca mund të çojë në shpërndarje të përmirësuar të burimeve, rritje të efikasitetit dhe perspektiva më të mira për zhvillim ekonomik.

Tolerancë zero

Një politikë që heton, ndjek penalisht dhe sanksion tërësisht të gjitha rastet e korrupsionit, pa marrë parasysh shkallën e ulët të rëndësisë së tyre.

U

Ushtrim i ndikimit

I njohur edhe si përdorimi i ndikimit. Ushtrimi i ndikimit ndodh kur një person i cili ndikon realisht ose në mënyrë të dukshme në vendimmarrjen e një zyrtari publik e shkëmben këtë ndikim për një avantazh të padrejtë. Vepra penale është e ngjashme me rryshfetin por ka një ndryshim të rëndësishëm: ushtrimi i ndikimit ka të bëjë me "ndërmjetësin" ose personin që luan rolin e ndërmjetësit ndërmjet vendimmarrësit dhe palës që kërkon një avantazh të papërshtatshëm. Vendimmarrësi përfundimtar mund të mos ketë dijeni për shkëmbimin e paligjshëm. Një shembull është kur një deputet merr një pagesë nga një shoqëri që të përpiqet të bindë kolegët ligjvënës të mbështesin ndryshimet që do të ndihmonin atë

shoqëri. Është e vështirë që ushtrimi i ndikimit të vërtetohet sepse përkufizimet ligjore përfshijnë kriteret e pasigurta të "qëllimit" dhe "ndikimit të panevojshëm"/të padrejtë. Gjithashtu, shpesh herë është e vështirë që të dallohet ushtrimi i ndikimit nga format e lejuara të lobimit.

V

Vepër penale e rëndë

Vepërtaria kriminale nga e cila rrjedhin të ardhurat e një krimi. Një vepër penale bëhet shkak për pastrimin e parave. Përcaktimi si vepër penale varet nga origjina e fondeve të përfshira.

Vigjilencë e duhur ndaj klientit

Detyrimi i institucioneve financiare që të zbatojnë procese identifikimi për klientët, domethënë të verifikojnë personat që pretendojnë se janë duke kontrolluar emrat e tyre, adresat e banimit etj.

Vlerësim (i korrupsionit)

Një vlerësim analizon situatën në një vend, sektor apo institucion duke identifikuar kështu mangësitë e sistemit dhe faktorë të tjerë (përfshirë dinamikën politike) që mundësojnë dhe mbështesin korrupsionin.

Vlerësim i rrezikut

Një proces sistematik i vlerësimit të rreziqeve ose rreziqeve të

mundshme që mund të përfshihen në një aktivitet ose ndërmarrje. Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit përshkruan fillimisht mënyrën se si funksionon një mekanizëm i caktuar qeverisjeje, përmes një hartëzimi të detajuar të të gjitha nënproceseve përkatëse. Pastaj, çdo element analizohet për të identifikuar mundësitë për korrupsion. Më pas, rreziqet e identifikuara vlerësohen për probabilitetin e shfaqjes dhe ndikimin e pritshëm, në mënyrë që të mund të identifikohen dhe zbatohen masat e duhura zbutëse. Së bashku, hapat përbëjnë një sistem të menaxhimit të rrezikut. Shihni gjithashtu Planin e Integritetit.

Z

Zbatim

Sanksionet e vendosura ndaj të dënuarve, për shembull burgosje, konfiskimi i pasurive të vjedhura dhe mbledhja e gjobave financiare.

Zh

Zhvatje

Praktika e marrjes së diçkaje (para, favore, pronë) nëpërmjet kërcënimit ose dhunës. Për shembull, zhvatja ndodh kur rojet e armatosura kërkojnë para për të kaluar nëpër një barrikade në rrugë. Mosofrimi i kujdesit mjekësor urgjent, përveç nëse paguhet ryshfet, mund të konsiderohet gjithashtu si një akt zhvatjeje.



**LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT
PARANDALIMI – NDËSHKIMI – NDËRGJEGJËSIMI**

MINISTRIA E DREJTËSISË
KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

Gjeni më shumë informacion në adresat:

www.drejtesia.gov.al

<https://shqiperiaqeduam.al>



"Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Cowater International dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian